



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 47

Prishtinë, më 13.02. 2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, kryetar, Ganimete Musliu, nënkryetare e parë, Rexhep Selimi, Anton Quni, Qerim Bajrami, Fatmir Shurdhaj, Nuredin Ibishi dhe Zafir Berisha, anëtarë.

Mungoi: Bojan Mitiq.

Përfaqësuesit nga Policia e Kosovës: Shpend Maxhuni-Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qala- Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Muhamet Berisha-Policia e Kosovës.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ganimete Zeka-Praktikante, Plator Avdiu- QKSS, Argjend Zejna- Grupo Parlamentar i AAK, Blend Zyrapi e Gent Gjokolli- KIPRED dhe Luanda Domi-DCAF.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

Raportimi i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, z. Shpend Maxhuni rreth situatës së sigurisë në Kosovë.

Kryetari e falënderoi drejtorin e Përgjithshëm të Policisë dhe më tutje theksoi që me kërkesë të deputetit Anton Quni dhe përkrahjen e deputetëve të tjerë është parë e nevojshme raportimi i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, lidhur me situatën në veri të vendit dhe shfaqjen e një grupi të uniformuar dhe pajisjet që e armatimit që bartin. Për këtë kërkoi një sqarim nga ana e z. Maxhuni, si është gjendja atje. Gjithashtu përgëzoi Policinë e Kosovës për aksionin e suksesshëm për ndaljen e trenit ilegal, që tentoi të hyjë në territorin e Kosovës. Fjalën ua kaloi anëtarëve të Komisionit për shtrimin e pyetjeve.

Anton Quni, duke iu referuar ditëve të fundit, ku një klub sportiv i uniformuar me pajisje ushtarake në një lokacion në veri të Kosovës kanë kryer disa aktivitete, tha se ndërkohë nga mediat janë ngritur dilemat se për çka është fjala. Për këtë arsye e konsideroi se duhet deklarimi i Policisë së Kosovës, i çfarë natyre është ky grup, a kanë leje të veprimit, cilat janë rreziqet? Më tutje theksoi që grup i tillë është nga komuniteti serb dhe që lëvizjet e tyre u ngjasojnë njësive speciale dhe armatimi që i ngjason armëve origjinale, duke versuar që për këtë situatë duhet të ketë përgjigjeje Policia e Kosovës, gjithashtu konsideroi që shqetësuese është që vërehet prezenca e disa zyrtarëve të Policisë së Kosovës, duke shpresuar që aktivitetet e tilla kanë qenë nën monitorimin e Policisë së Kosovës, pasi situata e tillë krijon një situatë paniku. Prandaj konsideroi që në këtë takim do duhej të sqaroheshin dilemat e tilla.

Zafir Berisha konsideroi që është përgjegjësi ligjore e Policisë së Kosovës që të menaxhojë situatën e sigurisë, duke theksuar që edhe në Komisionin për Punë të Jashtme, ku është anëtar, që në veri të vendit veprojnë tre deri katër organizata joqeveritare që financohen nga Rusia, por që veprimtaria e tyre është e dyshimtë, pasi disa nga këto organizata dhe veprimtarët e tyre janë kapur në Mal të Zi. Më tutje shtroi pyetjet: A janë të regjistruar organizatat e tilla në institucionet e Kosovës? Sa paraqesin rrezik organizata e tilla për stabilitetin e vendit?

Nuredin Ibishi e përgëzoi Policinë e Kosovës për aksionin e suksesshëm në ndalimin e trenit. Ndërsa sa i përket rastit të shfaqjes së organizatave në veri të vendit, shtroi çështjen e regjistrimit të tyre, si edhe themeluesit e këtyre organizatave Mumqillo Aller dhe Vuk Mitroviq dhe kjo çështje ka qenë në procedim penal. Duke iu referuar të kaluarës së z. Allon theksoi që ka qenë paramilitar në Bosnjë dhe se në vitin 2011, në afërsi të Zveçanit, është zënë me armatim dhe mjete eksplozive ku kanë zhvilluar aktivitete sportive. Më tutje theksoi se si shpjegohet kjo në aspektin legal, pasi Policia e Kosovës dhe KFOR kanë qenë në dijeni për këtë operacion në vitin 2011, ku personi në fjalë është zënë me armatim jashtë Kosovës. Gjithashtu konsideroi që, pavarësisht raporteve që ka Kosova me Serbinë bashkëpunimi duhet të ekzistojë dhe kërkoi një sqarim se si shpjegohet aktiviteti i tyre sportiv nga ana e policisë.

Rexhep Selimi theksoi se shkas i këtij takimi ishte gjendja në veri dhe ndërhyrja e njësive ushtarake brenda territorit të republikës, me kodin FEBIX-i 2016, të cilët ishin të pajisur me mjete ushtarake dhe ishte një manifestim i pa fshehur i tyre, të cilët mbanin uniformën e ushtrisë serbe. A është në dijeni Policia e Kosovës për lejen e dhënë për një aktivitet të tillë? Pasi përveç prezencës së policisë së Kosovës, u pa një dokument që mban vulën e policisë së Kosovës? Pyetja e dytë konsistonte në operacionin e ndaljes së trenit. Kush e dha urdhrin për ndaljen e trenit, nëse ka pasur urdhër?

Fatmir Shurdhaj shtroi pyetjet si vijon: Si është regjistruar Organizata Qeveritare me procedurat administrative të Kosovës? A janë shtetas të Kosovës personat që kanë regjistruar këtë OJQ? Duke e konsideruar shqetësuese situatën kur Policia e Kosovës ka hasur në persona që bartin eksploziv. Cila është mundësia e njësive kufitare të Kosovës, që të përgjojnë, vështrojnë kufirin? Kjo jo vetëm për personat dhe makinat, pro edhe pikat kufitare, pasi në kalimin e këtyre pikave kufitare, ka vërejtur që nuk bëhen kontrole me pajisje më të sofistikuara që mund të zbulonin fshehtësinë e substancave narkotike apo eksplozive. Nuk ka njësit të qenve që do të mund të bënin këtë punë. Sa është Policia e Kosovës e furnizuar me mjete që do të mund të kontrollonin pikat kufitare?

Qerim Bajrami shprehi brengën e njëjtë me anëtarët e tjerë të Komisionit për situatën e ndodhur në veri. Më tutje theksoi që dëshiron të ketë më shumë informacione, sa i përket grupeve të uniformuara dhe të armatosura që ushtrojnë në veri të vendit.

Gjithashtu theksoi që duke qenë se në pjesën e thellë të veriut jeton komuniteti boshnjak dhe duke qenë se janë pakicë në raport me komunitetin serb, i nënshtrohen presionit. Gjithashtu kërkoi që nga ana e Policisë së Kosovës të jepen përgjigjeje, për vrasjen e Shefko Salkoviq dhe dr. Mesud Gjekoviq, pasi këto dy raste nuk janë zbuluar ende.

Duke iu referuar përfaqësimit të komunitetit boshnjak në Policinë e Kosovës, konsideroi se do duhej të kishte më shumë pjesëtarë nga ky komunitet në struktura komanduese.

Kryetari konsideroi që Policia e Kosovës duhet të ketë parasysh që në të ardhmen komuniteti boshnjak të trajtohet në mënyrë të barabartë, marrë në konsideratë qëndrimin e komunitetit boshnjak në raport me Republikën e Kosovës.

Ganimete Musliu shtroi pyetjet si vijon: Kur ka ndodhur aktiviteti i konsideruar sportiv në veri të vendit, pasi nga mediat u pa që pamjet nuk janë të kohës së fundit? Cili ka qenë misioni i këtij grupi përmes ushtrimeve të tilla, tema e aktivitetit? Më tutje duke iu referuar takimit që ka realizuar me Shoqatën e Grave Police në veri të Mitrovicës, çështje të cilën e ka ngritur edhe në seancën e fundit, ku stacioni në veri është në gjendje të mjerueshme. A është mundësia e përmirësimit të kushteve të punës në këtë stacion? A mund të shtohet numri i të punësuarve të stafit civil për stacionin në veri të vendit?

Nuredin Ibishi, lidhur me rastin e datës 2 dhe 3 nëntor ku dy persona janë zënë me armatim dhe eksploziv, tha se personat e tillë kanë qenë nëpunës të qendrës kulturore dhe informative të Bashkimit Evropiane. Për më tepër EULEX dhe zyra e BE-së kanë shprehur "shqetësimin" për këtë veprim të tyre.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, theksoi që situata e krijuar ka shkaktuar reagim, si te Policia e Kosovës, Komisioni edhe te opinionin publik. Më tutje theksoi që

pasi janë shfaqur pamjet në televizion, është bërë komunikata nga ana e Policisë së Kosovës, Drejtoria Rajonale në veri të Mitrovicës nga z. Besim Hoti, është dhënë komunikata, ku janë afruar disa informacione për të sqaruar situatën e paraqitjes së njerëzve të uniformuar.

Policia e Kosovës në bazë të informacioneve të verifikuara që ka, bëhet fjalë për një grup Aero-Club(Aero-soft) i ashtuquajtur klubi-ujqit,të cilët janë të regjistruar si OJQ, organizatë joqeveritare e pavarur, jofitimprurës, e cila sipas hetuesve i përket shoqërisë sportive. Objektivi i saj është që të promovojë disiplina sportive. Informacionet e verifikuara nga Policia e Kosovës kjo OJQ është e themeluar në bazë të ligjit për bashkëpunimin në mes OJQ-vë, Ligji nr.4L/57. Kjo organizatë operon në veri të Mitrovicës dhe udhëhiqet nga Mumqillo Aller i lindu me 15.02.1976, origjina e tij është nga Republika e Kroacisë dhe banues në veri të Mitrovicës nga viti 1996. Pra, i njëjti është themelues i kësaj organizate bashkë me një person tjetër nga veriu i Mitrovicës.

Themeluesi i kësaj organizate, posedon dokumentacionin e Republikës së Kosovës, ndërsa në bazë të masave që ka ndërmarrë Policia e Kosovës për verifikimin e të kaluarës së tij kriminale nuk del në sistemin e Policisë së Kosovës që ka rënë ndesh me procedurat ligjore dhe personi në fjalë posedon vërtetimin nga gjykata kompetente që u ka të kaluar kriminale. Policia e Kosovës në hetimet e mëtutjeshme për anëtarët e tjerë të kësaj organizate, ka konstatuar se të gjithë anëtarët janë nga Komuna e Mitrovicës, me përjashtim të njërit nga Komuna e Istogut.

Bazuar në statusin e kësaj OJQ-je, mjetet të cilat përdorën për këtë veprimtari, janë një kategori pajisjesh që quhen përsëritëse që nuk kupton që nuk janë armë zjarri, pajisje të tilla shfrytëzojnë sfera plastike si municion për qëllimet e tyre sportive. Kjo organizatë është e regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike, ka licencën dhe numrin fiskal dhe të gjitha dokumentacionin për të operuar si organizatë. Nga informacionet e verifikuara nga Policia e Kosovës, njësitë e policisë së Kosovës kanë kontestuar se pajisjet që përdorën nga këta individ të kësaj organizate, janë pajisje që kryesisht janë blerë në dyqanin tregtar “Melodia-Piex” në Prishtinë, dhe janë në pronësi individuale të secilit person.

Edhe pas publikimit të këtyre informacioneve, nga Policia e Kosovës është bërë një ri-verifikim nga njësit e forenzikës rreth këtyre pajisjeve, dhe është konstatuar që pajisjet që në dukej janë si armë, por në realitet nuk janë dhe nuk shërbejnë si armë zjarri, dhe secila nga këto pajisje mbahet në pronësi të secilit individ. Pajisjet e tilla janë imituese të armëve sikur lodra dhe që shfrytëzohen nga klubi të tilla për qëllime rekreacioni

Më tutje theksoi që në ditën e mbajtjes së këtij aktiviteti, Policia e Kosovës ka qenë prezent dhe ka monitoruar këtë aktivitet. Aktiviteti i kësaj organizate është mbajtur gjatë muajit gusht të vitit 2016. Duke iu përgjigjur edhe pyetjes së z. Rexhep Selimi, theksoi që prezent të paktën kanë qenë dy pjesëtarë të Policisë së Kosovës, të autorizuar për monitorimin e këtij aktiviteti. Ndërsa sa i përket dokumentit të publikuar në media, ku është interpretuar që është autorizuar nga Policia e Kosovës, theksoi që konfirmon se dokumenti ka qenë dokument njoftues i asaj organizate dhe që është procedurë standarde, ku është deponuar në stacionin policor të Leposaviqit dhe vula në dokument është vula protokollare e Policisë së Kosovës me rastin e deponimit të çfarëdo dokumenti në Policinë e Kosovës, dhe nuk bëhet fjalë këtu për autorizim. Kjo nënkupton që aktiviteti i tillë është monitoruar nga Policia e Kosovës dhe nga raportet zyrtare të pranuar nga Policia e Kosovës, pajisjet e tilla para fillimit të aktivitetit sportiv, janë kontrolluar fizikisht nga policët e Policisë së Kosovës.

Aktiviteti ka zgjatur nga data 19 gusht deri më 21 gusht 2016 dhe sipas raportit të policisë, lokacioni ku është mbajtur aktiviteti është shfrytëzuar tri ditë. Në ditën e arë kanë qenë tre persona, në ditën e dytë dhe tretë numri i tyre është rritur. Anëtarët e kësaj OJQ-je kanë bërë kamping me tenda si pjese e eventit sportiv në atë pjesë të Komunës së Leposaviqit. Policia e Kosovës, ka ardhur në përfundimin që fotografit e prezantuar në media, konfirmohet që nuk kanë të bëjnë me aktivitetet të cilat janë ndërmarrë në zonën e përgjegjësive të Leposaviqit, ato fotografi janë marrë nga një ngjarje tjetër të cilat janë zhvilluar në territorin e Republikës së Serbisë.

Për të eliminuar çdo dyshim që kjo organizatë, ose të tjera mund të paraqesin rrezik në aspektin e sigurisë, janë dhënë udhëzimet e qarta në të gjitha njësitë për tërë territorin e Kosovës, për të përcjellë dhe informuar me kohë për çdo aktivitet që mund të ngritën shqetësime. Më tutje theksoi që ajo që mbetet për t'u diskutuar dhe vendor me institucionet e tjera relevante, ka të bëjë lidhur me kriteret për hapjen e organizatave joqeveritare.

Kryetari pyeti sa është numri i organizatave joqeveritare që veprojnë në Kosovë?

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, në përgjigjeje të pyetjes së kryetarit theksoi që nga informacionet që posedojnë afërsisht janë 9 000 (nëntëmijë) organizata joqeveritare dhe supozohet që numri i organizatave joqeveritare të hapura nga persona josh tetas të Kosovës, është mbi 400 (katërqind) organizata me fushëveprime të ndryshme. Më tutje theksoi që janë në koordinime me institucionet relevante dhe është rekomanduar që të rishikohet mundësia për revokim të lejë të organizatës e cila ka bërë ushtrimin në Leposaviq. Si shkas për këtë konsiderohet profili i z. Arllo, i cili del të jetë i involvuar në aktivitet kriminale jashtë Republikës së Kosovës, gjë për të cilën Policia e Kosovës e ka kuptuar më vonë, pasi mungon bashkëpunim i mirëfilltë me shtetin serb. Pra, nuk bëhet fjalë për njerëz të armatosur, por bëhet fjalë për aktivitete sportive të organizuara nga kjo OJQ dhe të monitoruar nga Policia e Kosovës. Ndërsa në përgjigjeje të pyetjes së dytë të z. Rexhep Selimi, lidhur me urdhrin e dhënë për ndaljen e trenit, theksoi që kjo çështje është bërë e qartë që vendimi për ndaljen e tretë e kanë marrë krerët e institucioneve shtetërore, ndërsa sa i përket veprimeve operative, dislokimin e njësisive speciale, e ka dhënë drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës.

Në përgjigjeje të pyetjes së z. Fatmir Shurdhaj, theksoi që Policia e Kosovës me kalimin e viteve është zhvilluar dhe është strukturuar mirë, ndërsa sa i përket kufirit me Serbinë theksoi që ende nuk është kryer transicioni dhe ajo pjesë mbetet në përgjegjësinë e KFOR-it. Policia Kufitare edhe në kufirin me Serbinë vazhdon të bëjë detyrat sipas koncepteve kufitare, gjithashtu operojnë edhe në vijën e gjelbër në bashkëpunim me KFOR-in. Pajisjet që aplikohen nga Policia e Kosovës janë mjaft të avancuara, pajisjet të cilat janë donacion nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmes ICITAP, pra, policia posedon pajisje të sofistikuara që detektojnë narkotikët edhe gjërat e tjera të dyshimta, ndërsa në qasjen operationale ditore përdoren edhe qentë dhe sipas nevojës dislokohen në atë pjesë. Ndërsa sa i përket luftës kundër narkotikëve, kjo çështje zhvillohet përmes analizave inteligjente, me policinë e Shqipërisë bashkëpunimi është në nivelin e duhur dhe nga viti në vit ka trend të uljes sa i përket parandalimit të narkotikëve.

Në përgjigjeje të z. Qerim Bajrami, se sa është i përfaqësuar komuniteti boshnjak në veri të vendit, theksoi që komuniteti boshnjak bënë një punë shumë të mirë dhe është i përfaqësuar. Ndërsa sa i përket rekomandimit të tij që duhet të ketë në struktura komanduese nga ky komunitet, theksoi që gjatë procesit të promovimit e kanë pas mundësinë e barabartë që të jenë pjesë e avancimeve. Më tutje theksoi që drejtori Rajonal i Gjilanit është i komunitetit boshnjak, zëvendësdrejtori në Drejtorinë e Rajonit të Pejës, është nga komuniteti boshnjak, ish-zëvendës

drejtori tashmë i ndjerë në Drejtorinë rajonale në Mitrovicë, dhe zyrtarë të tjerë në pozicione të tjera. Ndërsa theksoi që në të ardhmen, kur do të ketë nevojë për rekrutime të reja, komuniteti boshnjak të merret në konsideratë.

Ndërsa sa i përket pyetjeve të znj. Ganimete Musliu, falënderoi për ngritjen e çështjes sa i përket nevojave për kushte e punës, duke e theksuar stacionin në Dardani, i cili ende ndodhet në kontejner, në të cilin stacion Komisioni ka realizuar një vizitë punë. Më tutje theksoi që të gjitha stacionet policore, janë të trashëguara dhe një numër shumë i vogël janë bërë të reja. Policia e Kosovës, në vazhdimësi bënë kërkesa tek autoritete kompetente për realizimin e projekteve, duke theksuar që janë të arkivuara një sërë kërkesash që janë bërë tek institucionet kompetente, ku është kërkuar qoftë ndarja e parcelave ose definimin e pronësisë së objekteve, për të cilat nuk ka pasur përgjigjeje nga institucionet dhe që kërkesat e tilla janë përsëritur. Gjithashtu theksoi që stacionin policor në Zubin Potok është në shtëpi private. Ndërsa për stacionin policor numër 4 janë në procedurë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe së shpejti do të përcaktohet objekti i ri.

Ganimete Musliu theksoi që përveç se ka vështirësi në stacionet në Prishtinë, edhe në Gjilan nuk janë kushtet e mira dhe këtë e ka parë nga vizita që ka bërë atje, duke kërkuar një intervenim më të shpejtë dhe kërkoi përgjigjeje lidhur me këtë çështje, si dhe rritjen e numrit për stafin civil në veri të Mitrovicës.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, në përgjigjeje të znj. Musliu, theksoi se për këtë çështje janë në pritje nga Ministria e Administratës Publike, pasi kanë dërguar kërkesat dhe janë në pritje të përgjegjës, pasi ka nevojë për rritjen e numrit në gjithë Kosovën.

Nuredin Ibishi tha se sa i përket bashkëpunimit me Serbinë, në aspektin e bashkëpunimit policor, nuk ekziston bashkëpunim i drejtpërdrejtë. Kjo duhet të bëhet përmes EULEX-it dhe UNMIK-ut, duke shtuar që ka pasur kritika sa i përket edhe policisë së udhëhequr nga inteligjenca. A duhet pritur deri sa të ndodhin gjërat, pastaj të provohet t'u merret licenca organizatave të tilla? Si ka mundur të marrë certifikatën e së kaluarës kriminale, personi që është themelues kësaj organizate, përderisa ka probleme me ligjin? Kur regjistrohen OJQ-të, përveç nga gjykata, a marrin certifikatën e pastërtisë edhe nga Policia e Kosovës?

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, sa i përket bashkëpunimit me Serbinë, theksoi që kjo është situata, ndërsa është tentuar përmes EULEX dhe UNMIK, por nuk ka qenë gatishmëria nga pala serbe, ose në rrethanat kur janë përgjigjur, kanë qenë të kufizuara, ndërsa vullneti për të bashkëpunuar nuk mungon. Ndërsa sa i përket të kaluarës kriminale, theksoi që disa institucione e kërkojnë, por kjo mund të bëhet në baza vullnetare nga personi i caktuar dhe i jepet kjo leje sipas sistemit që posedon Policia e Kosovës, duke shtuar që Policia e Kosovës përkrah format e bashkëpunimit, duke theksuar që është dërguar rekomandimi te drejtorja përkatëse, që t'i revokohet leja OJQ-së e cila ka realizuar ushtrimet në pjesën veriore të vendit.

Rexhep Selimi, sa i përket infrastrukturës së Policisë së Kosovës dhe objekteve ku ndodhen, theksoi se çështjen e objekteve për stacionin policor numër 3 dhe numër 4 në Prishtinë, e ka adresuar te kryetari i Komunës së Prishtinës, i cili ka shprehur gatishmërinë për aq sa lejon hapësirë pozitive e kryetarit të mbështesë këtë proces. Përderisa dihet që administrimi i pronës

komunale bëhet me vendim të asamblesë komunale, sugjeroi që diskutimet për çështjen e objekteve për stacionet policore, të diskutohen në nivel qeveritar. Ndërsa duke iu referuar rastit të shfaqjes së grupit të uniformuar dhe të armatosur, me flamur serb, shtroi pyetjen. A duket se është çdo gjë në rregull, me shfaqjen e këtyre pamjeve? Më tutje konsideroi se ngjarja e tillë nuk duhet të shihet vetëm si ngjarje sportive, pasi është shqetësuese, duke uruar që mos të ketë ngjarje të tilla, dhe në rast se do të shfaqen të ketë ndërhyrje të policisë kufitare.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, theksoi se që nga momenti i shfaqjes së pamjeve, Policia e Kosovës ka angazhuar njësitë përkatëse duke ofruar informacionet e nevojshme. Gjithashtu shtoi që në asnjë situatë, nga ana e policisë nuk do të ketë minimizim e as mbivlerësim të situatave, duke shtuar që uniformat që barten nuk sanksionohen, gjithashtu edhe armët, ndërsa është e pa pranueshme bartja e flamurit të shtetit serb në territorin e Kosovës, për këtë gjë është iniciuar procedurë. Gjithashtu theksoi që ka qenë edhe një rast në Prizren, ku një person me uniformë të kamufluar është shfaqur në qytet, për të cilin është iniciuar po ashtu procedurë, duke shtuar që me përkushtimin më të madh do të punohet në zbatimin e ligjit.

Fatmir Shurdhaj, duke iu referuar procesit të integrimit në institucionet e shtetit të Kosovës, të pjesëtarëve të caktuar që kanë qenë pjesëtar të organizatave të ndryshme, ku integrimi i tyre ka ardhur si rezultat i bisedimeve të Brukselit, shtroi pyetjen. Sa ka arritur Policia e Kosovës, të bëjë verifikimin e organizatave të tilla, personave të tillë? A ka nga këto organizata, të cilave i është vazhduar leja për të vepruar edhe më tutje?

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, në përgjigjeje të pyetje së z. Shurdhaj, shtoi se Policia e Kosovës përcjell të gjitha trendët negativë, edhe për çështjet që nuk janë të specifikuar me ligj. Ndërsa s ai përket aminstitit të personave që kanë vepruar në veri, theksoi që për të gjithë ata persona që mund të jenë të dyshuar, policia ka informacione, por nëse ka interes më të veçantë, policia mund të ofrojë raport më të detajuar.

Zafir Berisha konsideroi që ndikimi i shtetit të Rusisë përmes organizatave të caktuara dhe përmes shtetit serb, kjo ndërhyrje është kërcënim për sigurinë. Çështja e sigurisë është e brishtë, pasi në vazhdimësi ka pasur raste, ku janë sulmuar institucionet e Kosovës të vendosura atje, qytetarë, zyra të partive, veprime që cenojnë sigurinë, ku aktivitet e organizatave të caktuara përmes veprimtarive të tyre kanë qëllim destabilizimin. Për këtë arsye kërkoi që të veprohet më seriozisht.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, theksoi që Policia e Kosovës, posedon informacione të karakterit inteligjent dhe matet obligim i institucioneve të vendit që të verifikojnë informacionet e tilla që mund të ndikojnë në aspektin e sigurisë, duke theksuar nevojën e përafrimit dhe bashkëpunimit ndërinstinucional për çështjet e interesit të Kosovës.

Anton Quni, duke iu referuar paraqitjes së grupit të armatosur me armë lodra dhe të unifromuar në veri të vendit, dhe duke marrë në konsideratë të kaluarën e personave që veprojnë në kuadër të asaj organizate, theksoi që është i sigurt që aktiviteti i tyre nuk është vetëm për sport, duke shtuar që edhe në programet e njësive elite, gjatë trajnimeve përdoret një lloj armatimi që nuk është armë, duke shtuar që shpreson që Policia e Kosovës, e ka situatën nën kontroll, që për grupet e tilla, të jepet vlerësimi nga Policia e Kosovës.

Kryetari shtroi pyetjet si vijon: a nënkupton që dorëheqja e drejtorit të Përgjithshëm të AKI-së, ka qenë si rezultat i mosbashkëpunimit me institucionet e tjera?

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, në përgjigjeje të pyetjes së kryetarit, theksoi që ka mësuar dorëheqjen pas publikimit të vendimit, ndërsa sa i përket bashkëpunimit të Policisë së Kosovës me AKI-n, theksoi që bashkëpunimi është në nivel dhe janë në bashkëpunim njëzet e katër orë.

Kryetari e falënderoi drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Shpend Maxhuni, për raportimin.

Më tutje, kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit, që është hartuar një shkresë për Qeverinë e Kosovës, për dërgimin e emrave për kompletimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi mungesa e tyre e bënë jofunksional këtë agjenci. Gjithashtu, sa i përket debatit që do të mbahet për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura, theksoi që do të prezantojë një rezolutë e cila do të përcaktojë kërkesat për qeverinë lidhur me transformimin e FSK-së, duke kërkuar një unitet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Të gjithë anëtarët prezent të Komisionit dhe kryetari u dakorduan, që në debatin për transformimin FSK-së në Forca të Armatosura, të ketë një unitet dhe dakordim për qëllimin që synohet, debati do të hapet nga kryetari i Komisionit, z. Daut Haradinaj.

Kryetari, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj